# INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË – PARADHENIA BANKARE (OVERDRAFT) ME PENG DEPOZITEN

## 1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës

| | |
|---|---|
| Banka<br>Adresa<br>Numri i Telefonit<br>Adresa e postës elektronike<br>Numri i Faksit<br>Adresa e *Web*-it | *Banka Amerikane e Investimeve*<br>*Rr. Kavajës, Nd.27, H.1, Nj.B.10, K.P.1001, Tiranë*<br>*+35542258755*<br><br>*+35542240752*<br>*www.abi.al* |

## 2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

| | |
|---|---|
| Lloji i Kredisë | *Paradhënia Bankare (Overdraft) është një limit kredie, për të financuar të gjitha nevojat afatshkurtra për likuiditet të individeve të cilët kanë një depozitë pranë Bankës Amerikane të Investimeve dhe nuk dëshirojnë të humbasin interesin e përfituar duke e thyer këtë depozitë përpara afatit të maturimit. Produkti nënkupton tërheqje para kohe të pjesshme të fondeve të depozitës me afat në emër të klientit dhe ripagim të principalit në ditën e afatit të maturimit.* |
| Vlera totale e kredisë dhe monedha | *Paradhënia Bankare (Overdraft) me peng depozitën lëvrohet vetëm në monedhën e depozitës që do të mbështesë kredinë në shumën:*<br>*Min: 100’000LEK/1’000EUR/1’000USD*<br>*Max: deri në 90% të vlerës së depozitës me afat* |
| Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve | *Ky produkt i ofrohet vetëm klientëve të cilët kanë një depozitë pranë Bankës Amerikane të Investimeve. Produkti Overdraft me peng depozitën i ofron klientëve mundësinë e tërheqjes nga llogaria e tyre personale më shumë para se sa gjendja në llogarinë e tyre personale. Shuma e përcaktuar bëhet e disponueshme në llogarinë rrjedhëse të pagës dhe klienti ka të drejtë ta tërheqë atë në çdo moment, duke krijuar një tepricë debitore në llogarinë e tij.* |
| Kohëzgjatja e kontratës së kredisë | *Deri në maturimin e depozitës me afat* |
| Këstet dhe kur është e mundur mënyra se si do të shlyhen këstet. | *Nuk parashikohet shlyerje me këste.*<br>*Interesi do të mblidhet cdo ditë dhe do të llogaritet mbi bazën e 360 ditëve të vitit financiar për numrin aktual të ditëve të kaluara, me normë vjetore të interesit të përcaktuar më parë. Klienti do të paguajë interes në fund të çdo 3-mujori, deri në ripagimin e plotë të shumave të disbursuara të këtij limiti, ose mund të zgjedhë që interesin e akumuluar ta paguajë bashkë me principalin në maturitetin e depozitës. Klienti paguan interes për shumën e përdorur të limitit të Overdraftit dhe për ditët e përdorura.* |

*E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura mund të mos jenë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat që do të përmbajë kontrata e huamarrjes, pasi ato janë subjekt i ndryshueshëm në varësi të të ardhurave të klientit, të kolateralit të ofruar, historikut të tij të kredisë në sistemin bankar, etj., elemente këto që do të analizohen dhe vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.*

<table>
<tr><td>Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar</td><td>
<table>
<tr><th colspan="2">Shembull</th></tr>
<tr><td>Limiti I Overdraftit</td><td>200,000</td></tr>
<tr><td>Norma e interesit</td><td>16%</td></tr>
<tr><td>Komision Disbursimi</td><td>4,000</td></tr>
<tr><td>Shuma e përdorur</td><td>25,000</td></tr>
<tr><td>Ditët e përdorura</td><td>15</td></tr>
<tr><td>Interes për tu paguar/muaj</td><td>1,66.7</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td>Garanci/siguri të nevojshme</td><td>Nuk kërkohet kolateral apo garantor.</td></tr>
</table>

## 3. Kostoja e kredisë

<table>
<tr><td>Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë.</td><td>Paradhënia Bankare (Overdraft) me peng depozitën lëvrohet vetëm në monedhën e depozitës që do të mbështesë kredinë LEKË me normë interesi – Normë Interesit Depozite + 2.5%</td></tr>
<tr><td>Norma efektive e interesit (NEI)</td><td>Norma efektive e interesit (NEI) përcakton koston totale që klienti do të përballojë për kredinë e marrë me kushtin që kredia do të shlyhet për periudhen e renë dakord, palët i përmbahen kushteve të përcaktuara në kontratë dhe interesi dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara deri në fund të maturimit të kredisë.<br>Klienti do të informohet për NEI në momentin e aplikimit dhe gjithashtu në disbursimin e fondeve (Aneksin e Planit të Pagesës).<br>Shembull Perfaqësues
<table>
<tr><th colspan="2">Interesi efektiv Linja / Ovd</th></tr>
<tr><td>Periudha ne vite</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Shuma qe do shlyej ne maturim</td><td>11,337,500</td></tr>
<tr><td>Limiti e linjes/ovd</td><td>10,000,000</td></tr>
<tr><td>Komision disbursimi</td><td>100,000</td></tr>
<tr><td>Komisione te tjera</td><td>500</td></tr>
<tr><td>Interesi nominal ne momentin e</td><td>13.37%</td></tr>
<tr><td>Data e lidhjes se kontrates</td><td>31/01/2012</td></tr>
<tr><td>Data e maturimit te kontrates</td><td>31/01/2013</td></tr>
<tr><td>Interesi Efektiv</td><td>14.52%</td></tr>
</table>
*) Komisione te tjera perfshin: sigurime te jetes,prones, komision administrimi,angazhimi etj.</td></tr>
<tr><td>A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar:<br>-kontratat e sigurimit për kredinë?</td><td>Nuk kërkohet kontratë sigurimi për këtë produkt.</td></tr>
<tr><td>Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.</td><td>
<table>
<tr><th>Lloji i shpenzimit</th><th>Vlera</th></tr>
<tr><td>Komision disbursimi</td><td>Nuk aplikohet</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td>Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese (p.sh. një kartë krediti).</td><td>Nuk aplikohet</td></tr>
</table>

*E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura mund të mos jenë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat që do të përmbajë kontrata e huamarrjes, pasi ato janë subjekt i ndryshueshëm në varësi të të ardhurave të klientit, të kolateralit të ofruar, historikut të tij të kredisë në sistemin bankar, etj., elemente këto që do të analizohen dhe vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.*

| | |
|---|---|
| Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë. | *Nuk aplikohet* |
| Kushtet, sipas të cilave kostot e sipërpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë. | *Nuk aplikohet* |
| Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale. | *Nuk aplikohet* |
| Kostot në rastin e pagesave me vonesë | *Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar (interesin ose kryegjën), Banka përveç normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 15% p.a., i llogaritur mbi detyrimin e këstit të radhës së pa paguar (principal + interes) për periudhën në të cilën ai është më vonesë në bazë të kushteve të kontratës.* |

## 4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

| | |
|---|---|
| E drejta për t'u tërhequr | *Huamarrësi ka të drejtën të tërhiqet nga kontrata e kredisë brenda një periudhe 14 (katërmbëdhjetë) ditore nga momenti i lidhjes së saj, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Bankës.* |
| Shlyerja (Pagesa) e kredisë para afatit të maturimit. | *Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë.* |
| Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit. | *Nuk aplikohet* |
| Informimi në rast refuzimi të kredisë | *Banka informon menjëherë konsumatorin në rast të refuzimit të overdraftit duke i vënë në dispozicion me shkrim arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim.* |
| Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës. | *Në rastet e ndryshimit të kushteve të punës, publikimi në mjediset e bankës pranohet si formë e mjaftueshme informimi.*<br>*Të tjera njoftime, kërkesa apo komunikime e tjera do të bëhen në adresën që klienti bën të ditur për bankën.*<br>*Ndryshimet e kushteve thelbesore të kontratës së huasë bëhen me shkrim.* |
| Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt bankës. | *Zyra e shërbimit për klientin.*<br>*Rr. Kavajes, Nd. 27/1, K.P 1001, Tiranë*<br>*Tel: 042258755-60*<br>*Email: customercare@abi.al* |
| Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor. | *Ky informacion është i vlefshëm per nje periudhe 7 ditore duke filluar prej datës…/…./….  deri në datën …/…./…*<br><br>*Gjatë kësaj periudhe kushtet e e përcaktuara janë të pandyshueshme* |

*E rëndësishme: Vlerat e sipërpërmendura mund të mos jenë përfundimtare dhe mund të mos përputhen me vlerat që do të përmbajë kontrata e huamarrjes, pasi ato janë subjekt i ndryshueshëm në varësi të të ardhurave të klientit, të kolateralit të ofruar, historikut të tij të kredisë në sistemin bankar, etj., elemente këto që do të analizohen dhe vlerësohen gjatë aplikimit për kredi, dhe për të cilat klienti do të informohet në vazhdim të procesit.*